

VENDIM
Nr.2, datë 12.1.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, në datën 12.1.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura kërkesën e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.

OBJEKTI: Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese, zonjës Vjollca Meçaj.

BAZA LIGJORE: Neni 127/2 i Kushtetutës, si dhe neni 9/2 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi shqyrtoi kërkesën,

VËREN:

Me dekretin nr.4353, datë 21.10.2004 të Presidentit të Republikës, zonja Vjollca Meçaj është emëruar gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese për pjesën e mbetur të mandatit të gjyqtarit Zija Vuci.

Rezulton se gjyqtari Zija Vuci, i emëruar për një periudhë 12-vjeçare, betimin para Presidentit të Republikës e ka bërë në datën 24.12.1994. Për rrjedhojë, data 24.12.2006 konsiderohet si datë e mbarimit të mandatit të gjyqtarës Vjollca Meçaj.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 127/2 të Kushtetutës, si dhe nenit 9/2 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Të deklarojë mbarimin e mandatit të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese, zonjës Vjollca Meçaj, në datën 24.12.2006.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.